

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtarin Binak Duqi dhe sekretaren juridike Valentina Rekaliu, në çështjen juridike të paditësit S.M.B.nga fshati B. komuna e P. i përfaqësuar nga av.M. H. nga P. me autorizim kundër të paditures KEK. Sh.a”Nëna Terezë”nr.36 me seli në Prishtinë, i përfaqësuar nga Milot Podvorica, me autorizim për kompenzim dëmi jomaterial dhe material, në shqyrtimin kryesor, publik të mbajtur në praninë e paditësit të autorizuarit të tij dhe përfaqësuesit të paditures, me dt.24.06.2016 mori këtë.

A K T G J Y K I M

REFUZOHET kërkesepadia e paditësit S.M.B. nga fshati. B., komuna e P., si e pabazuar me të cilën ka kërkuar që të **Obligohet** e paditura KEK me seli në Prishtinë, që ti paguaj paditësit me emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial shumën prej 25.000€, me kamatë ligjore, prej ditës së ngritjes së padisë e deri në ditën e pagesës, për shkak të djegies së shtëpisë me datë.07.05.2012, në fsh B. komuna e P. nga rryma elektrike si dhe të obligohet e paditura të ti bart shpenzimet e procedurës kontestimore të cilat do të krijohen gjatë zhvillimit të procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Obligohet paditësi që ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 30€, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi S. R.B. nëpërmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi pranë gjykatës në dt.18.05.2010 kundër të paditurës KEK, për kompenzim dëmi material dhe jomaterial për djegjen e shtëpisë së tij nga rryma elektrike me dt.07.05.2010 rreth orës 21:40 min.

Ai ka raportu rastin në drejtorin rajonale të policisë në Podujevë se i është djegur shtëpia në B. dhe i është lënduar bashkeshortja e tij. Nga raporti mbi hulumtimin e zjarrit lëshuar prej drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë në Podujevë vlerësohet djeg-ja e shtëpisë përdhes e ndërtuar me material të fortë dimenzionet 7X10m me një kthim 5X4 gjithësejt rreth 90m² e përbërë prej përdhesës, dy dhoma të fjetjes së fëmijëve, kuzhina, dhoma e fjetëjes së pronarit dhe banjo. Nga djegëja e shtëpisë janë djegur i tërë inventari, shtrojat, mbulojat dhe paisjet shtëpiake në

vlerë rreth 20.000€, ka propozuar me u caktuar eksperti për të caktuar bazën juridike dhe atë eksperti i elektros. Pas ekspertizës ka deklaruar se u vërtetua që zjarri është shkaktuar nga rryma elektrike dhe atij në mënyrë të pakontestueshme janë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale në shtëpinë e tij. Në seancën e datës 24.06.2016, ka deklaruar se nuk kemi nevojë ta ftojme ekspertin teknik- elektros që të ndëgjohet edhe pse më parë kishte propozuar një gjë të tillë sepse në shkresën e lëndës e kemi të mjaftueshme ekspertizën e tij. Në fjalën përfundimtare deklaroj se mbes në tërësi pranë padisë dhe kërkespadiës duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj si të bazuar dhe ta obligoj të paditurën t’ia kompenzoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 25.000€, me kamat ligjore duke llogaritur prej ditës së ngritjes së padisë në gjykat deri në pagesën përfundimtare. Pasi që me prova të cilat gjenden në shkresën e lëndës u vërtetua se shtëpia e paditësit është djegur nga zjarri i cili ka shkaktuar si pasojë e energjisë elektrike. Shpenzimet i ka kërkuar.

Paditësi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrah në tërësi të autorizuarin e tij në fjalën e tij përfundimtare.

Në të përgjigjurit në padi seanca dhe fjalën përfundimtare gjatë shqyrtimit kryesor e paditura nëpërmes të autorizuarit të saj ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkespadinë e saj si të pa bazuar si për nga baza ashtu edhe nga lartësia e saj. Ka kërkuar që gjykata të vërtetoj legjitimitetin e palës paditëse duke identifikuar se a është i njëjti pronar faktik dhe juridik i shtëpisë së djegur.

Nga raporti i hulumtimit të zjarrit rezulton se zjarri ka shpërthyer në tavan të shtëpisë në kabllon furnizuese e të cilin e kanë dëmtuar minjët. Po ashtu deklarohet se paditësi ka qenë neglizhent për sigurimin e provave e këtë e dëshmon fakti se plotë 19 dit pas zjarrit bënë kërkesë për dalje në vend ngjarje për vlersimin e dëmit. Andaj në këtë rast janë zhdukur në fakt gjurmët e shkaktarit të zjarrit. E paditura është e sigurt se zjarri nuk ka ndodh si pasojë e lëshimeve të saj dhe as që ka pasur ndonjë defekt në rrjet sepse sikur të kishte pasur ai do të ndikonte dhe do të shkaktonte dëme të ngjajshme edhe të konsumatorët e tjerë po që nuk ka ndodhur.

Nga ekspertiza e ekspertit të elektros në asnjë fakt nuk vëretetohet burimi i shkaktimit të zjarrit dhe ajo vetëm mund të supozohet siq deklaroj edhe eksperti në ekspertizë. Si shkaktar i zjarrit janë mangësit teknike tek instalimi dhe kjo bie në përgjegjësinë e vet konsumatorit pasi që e jona është e ndarë dhe varësisht se në provën e kujt ndodhet e përcaktuar me dispozita ligjore që dmth që zona ku ka ndodhur zjarri është në përgjegjësinë e vet paditësit kurse zona jasht objektit është përgjegjësinë e KEK-ut. Mirëpo në mungesë të provave dhe që paditësi është dashur në procedur paraprake të siguroj ato prova mirëpo i njëjti nuk e ka bërë këtë.

Paraqitja e zjarrit ka ardhur si pasoj e zhveshjes së kabllit furnizues në tavanin e shtëpisë së paditësit dhe është në përgjegjësinë e tij, dëmi i shkaktuar nga zjarri e jo përgjegjësi e të paditurës. Me prova në procedur u vërtetua mjaftueshëm se kërkespadija e paditësit është e pa bazuar në tërësi pasi që ai nuk ka bërë sigurimin e provave me kohë nga gjykata dhe të njëjtat i mungojnë në shkresat e lëndës. E paditura ka prova të mjaftueshme se ajo nuk është fajtoare andaj i propozojë gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkojë.

Gjykata për ta vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore në procedurën e provave bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave.

U lexua parashtrësja e paditësit drejtuar të paditues KEK për kompenzim e dt.17.05.2010 nr.2192, vendim me të cilin paditësi është invalid i UQK-së, vërtetim nga policia e Kosovës ku është raportuar djegëja e shtëpis nga paditësi i dt.14.05.2010, reference PK-AF-3202, raport mbi hulumtin e shkakur të zjarrit drejtoris për shërbime publike mbrojtëje dhe shpëtim Komuna Podujevë-zyra për parandalim dhe hulumtim të zjarreve nr.06/2010 dt.11.05.2010 si dhe i është bashkangjitur një fotografi e shtëpis së djegur, përgjigjëja në padi e të paditues dt.19.01.2015, vërtetim me të cilin vërtetohet se paditësi është tatimpagues i rregullt i paluajtshmërisë dt.20.07.2015 i lëshuar nga Komuna e Podujevës, fotot që gjenden në shkresat e lëndës ku është evidentuar paluajtshmëria e paditësit, vërtetim i lëshuar nga drejtoria për buxhet dhe financa, zyra e tatimit në pronë nr.04/3199 dt.17.05.2010, fatura e tatimit në pronë, fotografi e shtëpis se ndërtuar më pastaj nga paditësi pas djegëjes, fotografi e shtëpis se djegur e paditësit, qerfifikata e vdekjes se babait të paditësit lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Podujevë me dt.28.03.2013, po ashtu qertifikata e vdekjes për nënën e paditësit M. B., ekstrakti i lindjes për paditësit, qertifikata mbi të drejtat e paluajtshëmrive e lëshuar nga ZKK 08/714/65496/15 dt.20.07.2015, fatur për rrymën që paguan paditësi, aktvendim me të cilin është caktuar eksperti i elektros i kësaj gjykate 16.07.2015, si dhe ekspertiza teknike për shkakun e lartësis së zjarrit eksperti Y. Z. Nëntor 2015.

Pas administrimit të provave një nga një e të gjitha së bashku konform nenit 8 të LPK-së, gjykata gjeti se kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e pa bazuar dhe si të tillë e refuzojë ashtu siq është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk është kontestuese fakti për gjykatën se me dt.07.05.2010 i është djegur shtëpia e paditësit në fshatin B. komuna P., ky fakt vërtetohet nga gjykata nga deklarimi i palëve në seanca, thënjet në padi dhe përgjigje në padi si dhe raporti mbi hulumtimin e shkakut të zjarrit, drejtorisë për shërbime publike komuna e Podujevës-Zyra e parandalimit dhe hulumtimit të zjarreve nr.06/2010

dt.11.05.2010, fotografit në shkresat e lëndës si Raporti i Policisë dt.14.05.2010 Nr.rasti 2010-AF-0531.

Nuk është kontestues fakti për gjykatën se shtëpia e djegur e paditësit në B. ishte në pronësi të tij, ky fakt vërtetohet prej gjykatës nga deklarimi i palës paditëse, vërtetimi me të cilin vërtetohet se tatim paguesi-paditësi ka kryer obligimet pjesërisht ndaj Komunës së Podujevës dt 20.07.2015, vërtetimi nr.04/3199 dt.17.05.2010, fatura e tatimit në pronë 20.07.2015, qertifikata e vdekjes për babain e tij dt.28.03.2013, dhe për nënën e tij dt.29.03.2013, qertifikata e lindjes së paditësit dt.17.04.2014, të gjitha të lëshuara nga zyra e gjendjes civile në Podujevë, Certifikata e drejtës së paluejtshmërive e lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit si dhe fatura e pagesës së energjise elektrike dt.21.03.2011.

Kontestues ishte fakti se kush është përgjegjës në rastin në fjalë dhe dëmi i shkaktuar nga djegëja e shtëpis së paditësit, kush mban përgjegjësin për këtë dëm, paditësi apo e paditura me një fjalë kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë.

Gjykata për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë në procedurën e provave bëri dhe nxjerrjen e provës nga eksperti i elektros Y. Z. nga P. në muajin Nëntor 2015, po ashtu i vërtetoi edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat të lëndës.

Pas vlerësimit nga ana e gjykatës të ekspertizës së ekspertit të elektros dhe provave tjera një nga një e në lidhshmëri në mes tyre në mënyrë të kujdesshme vërtetoi se:

Paditësi me prova të ofruara nuk e bëri të besueshme dhe të bazuar kërkesëpadinë e tij dhe kjo nuk u vërtetua me asnjë provë të vetme me të cilat gjykata duhet të bindej se e paditura është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar nga zjarri prej energjise elektrike e i cili zjarr e ka përfshirë shtëpin dhe djegur të paditësit që gjendet në fshatin B. me dt.07.05.2010. Kjo përgjegjësi është paraparë për konpenzim dëmit me LMD-në, në dispozitat që ka të bëjë me shkaktarin e dëmit ta parapara me nenet 154.1, 155, 158, 185 dhe 200 të LMD-së, 1978.

Nga provat raporti mbi hulumtimin e shkakut të zjarrit dt.11.05.2010, nr.06/2010 i Drejtorisë për shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim Komuna e Podujevës- zyra e parandalimit dhe hulumtimit të zjarreve gjykata vërtetoi se me dt. 07.05.2010 zyra në fjalë është njoftuar nga kujdestari i SHZSH për zjarrin e shkaktuar në shtëpin e paditësit në B. rreth orës 22.30h, Inspektori i kësaj zyre R. B. dt.08.05.2010 rreth orës 10.00h, ka dal në vendngjarje. Në pjesën ku përshkruhet shkakun i shpërthimit të zjarrit ndër të tjera thuhet se: Gjatë shikimit dukeshin përquesit e kabllove elektrike me shenja të kontakteve të shkurtra elektrike që dëshmon në temperatura të larta gjatë zjarrit. Instalimi ishte i renovuar me pajisje të reja elektrike, me

mbrojte të qarqeve elektrike, me siguresa automatike si dhe distancore që eliminon mundësin e shkaktimit të zjarrit nga defektet e instalimit elektrik brenda shtëpisë.

Mirëpo supozohet kabli furnizues elektrik nga shtylla elektrike ka pasur shpërthime nga kontaktet e shkurtra primare si pasojë e zhveshjes nga minjët në tavanin e shtëpisë ku ka qenë e shtrirë kabli deri tek njëhsori. Me qka vërtetohet dhe deklarimi dhe kundërshtimi i drejtë i bërë gjatë shqyrtimit nga pala e paditur se defekti ka filluar nga brenda objektit të paditësit dhe kjo ka ndodhur jashtë zonës së përgjegjësisë së paditues andaj ajo nuk mban përgjegjësis për dëmin e shkaktuar paditësit nga zjarri i energjisë elektrike në shtëpin e tij sepse ajo mban përgjegjësin vetëm jashtë objektit. Andaj ky është burimi i parë dhe prova e parë e konstatuar pas djegëjes së shtëpisë së paditësit në vend të ngjarjes dhe gjykata jep besimin e plotë kësaj provë materiale.

Nga prova e nxjerrur nga gjykata ekspertizën e ekspertit të elektros Y. Z. nga P. ëe dhënë në Nëtor të vitit 2015 gjykata vërtetoi se eksperti në pjesën nr.IV faqen e fundit ku është titulli konstatimi i shkaktarit të zjarrit thuhet se zjarri është bërë nga rryma elektrike, burimi i zjarrit në munges të provave teknike nga vendgjarja nuk mund të argumentohet por mbetet vetëm supozim qka dmth se sikur paditësi të ishte treguar me i kujdësishëm dhe të kishte bërë sigurimin e provave nga gjykata me ekspert në momentin e pas ndodhjes së zjarrit ndoshta do të ishte vërtetu shkakatri i vërtet i zjarrit por ai nuk e ka bërë këtë me kohë qka aludon dhe pala e paditur me të drejtë.

Në pikën 3 të ekspertizës thuhet se shkaktari i paraqitjes së zjarrit janë mangësit teknike të instalimit teknik dhe 4 përgjegjësia nuk mund të përcaktohet në munges të fakteve dhe provave.

Gjykata duke u bazuar në kodin e shpërndarjes 2008 KEK dhe KOST neni 5.5.3 kufijt e pronësisë në nenin 5.5.3.1 thuhet se: pika apo pikat në të cilat është vënë apo është marrë furnizimi i energjisë elektrike ndërmjet sistemit të shpërndarjes dhe instalimit të përdoruesve duhet të dakordohet në mes të OSSH dhe përdoruesit ashtu siq kërkohet.

Neni 5.5.3.2 cek se: përfurnizimet e TU përgjegjësia e OSSH-së, zgjerohet deri tek pika e kyqjes së konsumatorit e cila normalisht është:

a). Në shumicën e rasteve tek daljeve TMRR dhe hyrje në ndërprerësin kryesor tek furnizimi konsumatorit dhe

b). Në objekte afariste dhe të amvisërisë në pikën e kyqjes në pjesën e pasme të njehësorit ose në anën e furnizimit të ndërprerësit kryesorë siguresa Kryesore, mbarim i citatit.

Andaj nga këto kuptojmë se vërtetohet kundërshtimi i palës së paditur e cila thekson vazhdimisht pa ndërprerë se përgjegjësia e të paditures është jasht objektit kurse në rastin konkret kjo bije në përgjegjësoi të paditsit që zjarri ka shpërthyer brenda objektit të paditësit.

Andaj meqenëse nuk mundi të vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë në mungesë të provave dhe me lëshimet e vet paditësit i cili nuk u tregua i kujdesshëm të bëjë me kohë sigurimin e provave menjëherë pas djegëjes së shtëpisë dhe dëmit të shkaktuar e që sigurimi i provave bie në bazë të palës paditëse sipas nenit 7.1 LPK-së, atëherë ku e paditura nuk mund të jetë përgjigje për dëmin e pësuar të paditësit sipas dispozitave të LMD-së, të cekura më lart dhe nuk mban përgjegjësi për këtë.

Gjykata në mungesë të bazës juridike të kërkesëpadisë e cila nuk mundi të vërtetohet nga provat e ofruara nga pala paditëse e refuzojë kërkesëpadinë e tij si të pabazuar dhe pa mbështetje në prova në procedurë.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori konform neneve 449, 450, 452.1 dhe 453 LPK-së, si dhe UA 2008/02 KGJK për unifikimin e taksave gjyqësore i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimet e LGJK nr.20/12 dt.09.03.2012 dhe KGJK 37/12 dt.23.03.2012 dhe obligojë paditësin ta paguajë shumën prej 120€, për taksë gjyqësore pasi që kishte paguar më parë 20€, për padi dhe Aktgjykim konform suksesit në kontest neni 452.1 LPK-së.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
C.nr.270/10 dt.24.06.2016

Gj y q t a r i:
Binak Duqi

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur kundër këtij Aktgjykimi ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.